



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. _____
 Dep. DPK
 Nr. i faq _____
 Broj .trаница _____
 Nr. pages 02

Nr Prot _____
 Br Prot _____
 Prot No 03-02/2136/18
 Data _____
 Datum 30-07-2018
 Date _____

PRISHTINE



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 27.07.2018, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-1024/18, për z. Shemsi Veseli, Anëtar i Bordit në Shërbimin Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës, për shkak se zyrtari i lartë e ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funkcionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Shemsi Veseli, Anëtar i Bordit në Shërbimin Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës dhe njëkohësisht U.D. Drejtor i Klinikës së Biokimisë Mjekësore në Qendren Klinikë dhe Universitare të Kosovës, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Agjencia kundër Korrupsionit, fillimisht e ka njoftuar zyrtarin e lartë me një shkresë zyrtare për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit. Pas pranimit të kësaj shkrese është organizuar një takim me zyrtarin e lartë. Gjatë këtij takimi, zyrtari i lartë është njoftuar se krahas ushtrimit të funksionit Anëtar i Bordit në Shërbimin Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës nuk mund të ushtrojë njëkohësisht edhe funksionin U.D. Drejtor i



Klinikës së Biokimisë Mjekësore në Qendren Klinike dhe Universitare të Kosovës për faktin se Bordi Drejtues është organ më i lartë vendimarrës në SHSKUK i cili e emëron dhe e mbikëqyrë Drejtorin e Përgjithshëm në Qendren Klinike dhe Universitare të Kosovës, tek i cili raporton z. Shemsi Veseli nga funksioni U.D. Drejtor i Klinikës së Biokimisë Mjekësore në Qendren Klinike dhe Universitare të Kosovës. Prandaj në këtë situatë ekziston konflikt i interesit “rast për rast” e që si rregullë me përsëritjen e tij është shëndrruar në konflikt të vazhdueshëm të interesit neni 17 (paragrafi 1,2,3,4,5).

Po ashtu, angazhimi i tillë është në kundërshtim me parimet e veprimit dhe mosveprimit të zyrtarit neni 5 (paragrafi 1 dhe 2), në të cilin shprehimisht thuhet:

2. Zyrtari duhet ta kryejë punën e tij me ndershmëri, ndërgjegje, paanshmëri, të ruajë autoritetin e zyrtarit dhe institucionit dhe me punën e tij të forcojë besimin e qytetarëve në institucione.

9. Zyrtari nuk mund të përdorë pozitën apo funksionin e vet për t'i avancuar interesat e veta personale apo të personave të afërm.

Sipas procedurës së paraparë në Ligjin për parandalimin e konfliktit të interesit, Agjencia i ka dërguar shkresë paralajmëruese zyrtarit të lartë, me të cilën i është kërkuar të heq dorë nga njëri funksion brenda afatit ligjore, përndryshe Agjencia është e obliguar të veproj konform nenit 22 paragrafi 8 të Ligjit nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Ndërkohë, pas kësaj, Agjencia ka pranuar shkresën zyrtare (DPKI.03-02/1572/18) me të cilën dëshmohet se zyrtari i lartë z. Shemsi Veseli, për të shmangur konfliktin e interesit ka dhënë dorëheqje nga funksioni U.D. Drejtor i Klinikës së Biokimisë Mjekësore në Qendren Klinike dhe Universitare të Kosovës, duke vazhduar detyrën e tij si Anëtar i Bordit në Shërbimin Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

